

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS I UNIVERSITETIT TË
TIRANËS**

Njoftim për vend të lirë pune

Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për personel administrativ, Kryetare në Degën e Financës dhe Buxhetit.

a- Kriteria të përgjithshme:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punë për të cilin konkurrojnë.
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

b- Kriteria të veçanta:

1. Të jetë diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, dega Financë ose Financë-Kontabilitet.
2. Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit dhe kontabilitetit.
3. Të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet, në sektorin publik.
4. Preferohet të ketë përfunduar studimet e larta në UT.
5. Të ketë trajnime në fushën e financës.
6. Të njohë një gjuhë të huaj perëndimore, preferohet anglisht.
7. Të dijë të punojë në grup, të ketë aftësi organizuese dhe drejtuese.
8. Preferohet të ketë eksperiencë në funksione drejtuese në Financë (të paktën tre vjet).

Kandidatët konkurrentë duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim.
2. Curriculum vitae.
3. Diplomë dhe listë notash të studimeve universitare (fotokopje e noterizuar). Për diplomat emarra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent.
4. Dëshmi të njohjes, certifikatë apo dëshmi kualifikimi që kanë (fotokopje e noterizuar).
5. Dëshmi të njohjes të kompjuterit (fotokopje e noterizuar).
6. Dëshmi të njohjes të një gjuhe të huaj (fotokopje e noterizuar).
7. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit.
8. Dëshmi penaliteti.
9. Dokument identifikimi.
10. Kopje të librezës së punës dhe të librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërore.
11. Raport mjekësor për aftësi në punë.

Dokumentat pranohen pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-se nga data 20.09.2021-04.10.2021.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.